



AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

RAPORT VJETOR I PUNËS 2022


Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 59 58 100

Email: info.ashna@rks-gov.net

Uebfaqe: www.ashna-ks.org



Mesazhi i Drejtorit



Të dashur miq dhe bashkëpunëtorë,

Kam kënaqësinë të ndaj me ju edhe këtë vit raportin vjetor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, përmes të cilit kemi shpalosur informacione kyçe të cilat pasqyrojnë punën tonë të përbashkët gjatë vitit 2022.

Pas një periudhe dyvjeçare, ku ASHNA u përball me vështirësi të theksuara në aktivitetet dhe projeksionet e saj zhvillimore si pasojë e pandemisë

Covid 19, në vitin 2022 filluam të operojmë me kapacitete të plota dhe arritëm që me sukses të ofrojmë shërbim të pandërprerë 24/7, gjithmonë duke ruajtur nivelet më të larta të sigurisë së operimeve dhe gjithashtu duke i kushtuar vëmendje të vazhdueshme shëndetit dhe mirëqënies së personelit.

ASHNA me sukses të plotë ka përmbushur detyrat e saj në arritjen e objektivave kryesore të sigurisë dhe krahas kësaj ka zhvilluar dhe implementuar projeksione të rëndësishme strategjike në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore.

Përgjatë vitit 2022, ASHNA ka arritur të përfundoj një sërë projektesh të rëndësishme të veçantë në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe njerëzore për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror.

Vlerësoj përkushtimin maksimal të personelit dhe përkrahjen nga institucionet tona vendore dhe partnerëve tanë të çmuar, me të cilët në harmoni të plotë dhe të vazhdueshme bashkërenduam veprimet për normalizim të plotë të hapësirës së ulët ajrore, si dhe dizajnuam plane përkatëse për menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës.

ASHNA mbetet e përkushtuar në përmbushjen dhe arritjen e detyrave dhe objektivave të saj, duke garantuar siguri dhe cilësi për gjithë shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja

Mesazhi i Drejtorit	3
Përmbajtja.....	4
Profili i kompanisë.....	5
Misioni dhe Visioni	7
Shërbimet dhe Aktivitetet Kryesore	8
Aktivitetet Kryesore	9
Struktura Organizative	10
Takime dhe Vizita	11
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	15
Rrjedha e trafikut.....	16
Përmirësimet operative.....	20
Koordinimi Civil-Ushtarak.....	29
Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë	30
Menaxhimi i Sigurisë	30
Menaxhimi i Cilësisë	32
Menaxhimi i Sigurimit	34
Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës	35
Performanca Financiare	46
Menaxhimi i Rreziqeve të Organizatës	65
Shërbime tjera	66
Burimet Njerëzore	67
Prioritetet për 2023	71

Profili i kompanisë

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) është organizatë buxhetore e themeluar si agjenci e pavarur me Ligjin për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror 04/L-250 (publikuar në gazetën zyrtare nr.28, më 28.04.2014). Ligji ka filluar të implementohet më 01 janar 2016.

Me procesin e koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” (prill 2011), shërbimet e navigacionit ajror mbetën jashtë projektit të koncesionimit, duke u organizuar dhe funksionuar për një periudhë kalimtare nën statusin e ndërmarrjes publike “ANP Adem Jashari” - Kontrolli Ajror.

ASHNA ofron shërbimet e navigacionit ajror të renditura në vijim, prej nivelit GND (tokë) deri në FL 205 (6250m) për të gjitha kategoritë e trafikut civil dhe ushtarak.

Veprimtaria e ASHNA-së përkufizohet në katër shërbimet kryesore në vijim. Puna e këtyre shërbimeve mbështetet nga shërbimet e çmuara administrative dhe financiare.


Duke qenë se siguria është objektiv dhe qëllim kryesor i ASHNA-së, sistemi i menaxhimit të sigurisë mbetet mekanizmi kryesor për ruajtjen, monitorimin dhe ngritjen e sigurisë.



- **Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror**
- **Shërbimet e Informacioneve Aeronautike**
- **Shërbimet Meteorologjike dhe**
- **Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi**

ASHNA ka 164 të punësuar, kryesisht të shkolluar dhe përgaditur në institute te specializuara europiane.

Historiku



Misioni dhe Visioni



Visioni

ASHNA do të jetë konkruuese në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon

Misioni

Normalizimi dhe ofrimi i sigurt i shërbimeve të navigimit ajror për shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.

Shërbimet dhe Aktivitetet Kryesore

Shërbimet kryesore

ASHNA është e certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC) për shërbimet në vijim:

Shërbimet e Trafikut Ajror

- Kontrolli i Trafikut Ajror (ATC)
- Shërbimi i Informacionit të Fluturimit (FIS)
- Shërbimi Këshillues për Trafikun Ajror
- Shërbimi i Alarmimit

Shërbimet e Informacioneve Aeronautike

- Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP)
- Procesimi i NOTAM-ëve (NOF)
- Shërbimi raportues Aeronautik (ARO)

Shërbimet Meteorologjike

- Parashikim
- Vrojtim

Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi

- Komunikim
- Navigim
- Survejim




Aktivitetet Kryesore

Në përputhje me autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë, ASHNA gjatë vitit 2022 kryesisht ka zhvilluar aktivitetet e paraqitura në vijim.

- Planifikime Buxhetore
- Përgaditja e planeve të punës
- Ngritja e kapaciteve njerëzore
- Raportime
- Auditet e sigurisë
- Mitigimet e sigurisë
- Normalizimi i hapësirës ajrore
- Implementimi i projektit “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Nërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”
- Implementimi i procedurave të reja instrumentale konvecionale dhe PBN (performance based navigation)
- Implementimi i projektit “Radari Mode S/I në lokacionin e Gjakovës”
- Implementimi i sistemeve të radiokomunikimit
- ISO Çertifikimi

Struktura Organizative



Takime dhe Vizita

Takime

Pëveç takimeve të rregullta të niveleve të ndryshme organizative brenda agjencisë, ASHNA ka zhvilluar edhe takimet e rregullta të Komitetit për Buxhet dhe Siguri (KBS). Gjatë vitit 2022, KBS ka mbajtur 5 takime, temat dhe vendimet e të cilave janë paraqitur në tabelën në vijim.

KBS është organi më i lartë brenda agjencisë, ku trajtohen çështjet e sigurisë dhe buxhetit.

Nr.	Data	Tema
1	09.02.2022	Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 33-të e KBS Agjenda – diskutimi dhe aprovimi i raporteve vjetore të departamenteve për vitin 2021. Konkluzë: Aprovohen raportet vjetore të departamenteve për vitin 2021.
2	11.05.2022	Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 34-të e KBS Agjenda – diskutimi dhe aprovimi i raporteve të departamenteve për periudhën janar-mars -2022. Konkluzë: Aprovohen raportet e departamenteve për periudhën Janar-Mars 2022.
3	28.07.2022	Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 35-të e KBS Agjenda – diskutimi dhe aprovimi i raporteve të departamenteve për periudhën prill - qershor. Konkluzë: Aprovohen raportet e departamenteve për periudhën Prill-Qershor 2022.
4	20.10.2022	Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 36-të e KBS Agjenda – diskutimi dhe aprovimi i raporteve të departamenteve për periudhën korrik – shtator 2022. Konkluzë: Aprovohen raportet e departamenteve për periudhën Korrik-Shtator-2022.

5	27.12.2022	<p>Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 37-të e KBS</p> <p>Agjenda:</p> <p>Rishikimi i menaxhmentit Aprovimi i planit të anketimeve të sigurisë për vitin 2023 Aprovimi i planit të auditeve të cilësisë për vitin 2023</p> <p>Raportimi mbi gjendjen:</p> <ul style="list-style-type: none">a. gjetjeve nga auditet e AAC-së,b. gjetjet dhe rekomandimet nga hetimet e sigurisë në ASHNA, dhec. hazardet e identifikuar në departamentet operative <p>Konkluzë:</p> <p>Aprovohet Rishikimi i menaxhimit</p> <p>Aprovohet plani i anketimeve të sigurisë për vitin 2023</p> <p>Aprovohet plani i anketimeve të cilësisë për vitin 2023</p> <p>Aprovohet Raportimi mbi gjendjen:</p> <ul style="list-style-type: none">a. gjetjeve nga auditet e AAC-së,b. gjetjet dhe rekomandimet nga hetimet e sigurisë në ASHNA, dhec. hazardet e identifikuar në departamentet operative
---	------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Vizita

Vizita e Kryeministrit

Në shkurt të vitit 2022, Kryeministri Albin Kurti, bashkë me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe anëtarë tjerë të qeverisë, vizituan ASHNA-në. Gjatë kësaj vizite, Kryeministri u njoftua nga afër me shërbimet, punën, planet dhe nevojat e ASHNA-së. Përveç vizitës nëpër njësi operative, u zhvillua edhe një takim i përbashkët, ku shpalosëm në detaje misionin dhe vizionin e ASHNA-së.

Kryeministri shprehu interesim të theksuar lidhur me nevojat dhe të veçantat e punës sonë, si dhe u zotua për mbështetje maksimale për projeksionet zhvillimore të ASHNA-së.



Vizita e Ministrave Aliu dhe Mehaj



Në mars të vitit 2022, Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu si dhe Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj vizituan ASHNA-në.

Gjatë këtij takimi u diskutua për të arriturat dhe planet afatgjata të ASHNA-së, funksionalizimin e plotë të sistemit aktual të Menaxhimit të Trafikut Ajror, ngritjen e kapaciteteve njerëzore, si dhe për intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Duke pasur parasysh që aktiviteti i ASHNA-së për nga natyra, fushëveprimi dhe rregullimi, kalon kufinjët vendor, ne jemi përkujdesur që të mbajmë dhe zgjerojmë nivelet tona të bashkëpunimit ndërkombëtarë edhe gjatë vitit 2022.

Ky bashkëpunim ka qenë i fokusuar në hapjen e mundësive të reja për normalizim të plotë të hapësirës ajrore të Kosovës, integrim në organizma të rëndësishëm global, si dhe në ngritjen e kapaciteve teknike dhe njerëzore.

Janë zhvilluar takime dhe komunikime me operatorët ajror, agjencitë fqinje të navigacionit ajror, Eurocontrol, CANSO, NATO, KFOR, si dhe me palë tjera të interesit.

ASHNA ka koordinuar aktivitetet e saj në rrafshin ndërkombëtar me autoritetet qeveritare vendore.



Rrjedha e trafikut


Viti 2022 është shënuar me rritje të numrit të fluturimeve komerciale prej 21.4 %, që nënkupton 21616 operime ajrore komerciale, 1546 ushtarake dhe 3555 të tjera (GAT/VFR).

Të gjitha këto operime janë zhvilluar në përputhëri të plotë me rregullativin vendor dhe ndërkombëtar. Vlen të theksohet se ky trafik është realizuar rrjedhshëm, me efikasitet të plotë dhe duke ruajtur nivelet e sigurisë edhe në kushtet e punimeve në progres të projektit të zgjatjes së pistës.

Në vijim kemi paraqitur të detajuara raportet statistikore për çdo kategori trafiku ajror, duke i krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Operimet Komerciale

OPERIMET KOMERCIALE TE MENAXHUARA 2021 - 2022			KRAHASIMI ME VITIN PARAPRAK	
Muaji	2021	2022	Nr. i operimeve	Përqindja
Janar	1156	1587	431	37.3%
Shkurt	780	1075	295	37.8%
Mars	841	1361	520	61.8%
Prill	737	1955	1218	165.3%
Maj	1149	1861	712	62.0%
Qershor	1377	1976	599	43.5%
Korrik	2720	2668	-52	-1.9%
Gusht	3026	2602	-424	-14.0%
Shtator	1660	1837	177	10.7%
Tetor	1598	1700	102	6.4%
Nentor	1118	1328	210	18.8%
Dhjetor	1642	1666	24	1.5%
TOTAL	17804	21616	3812	21.4%




Operimet Ushtarake

OPERIMET USHTARAKE			KRAHASIMI ME VITIN PARAPRAK	
Muaji	2021	2022	Nr. i operimeve	Përqindja
Janar	105	94	-11	-10.5%
Shkurt	107	108	1	0.9%
Mars	118	120	2	1.7%
Prill	126	249	123	97.6%
Maj	93	151	58	62.4%
Qershor	105	150	45	42.9%
Korrik	169	117	-52	-30.8%
Gusht	163	87	-76	-46.6%
Shtator	182	144	-38	-20.9%
Tetor	164	107	-57	-34.8%
Nentor	125	90	-35	-28.0%
Dhjetor	137	129	-8	-5.8%
TOTAL	1594	1546	-48	-3.0%



Operimet GAT/VFR

OPERIMET VFR			KRAHASIMI ME VITIN PARAPRAK	
Muaji	2021	2022	Nr. i operimeve	Përqindja
Janar	144	246	102	70.8%
Shkurt	206	270	64	31.1%
Mars	187	246	59	31.6%
Prill	205	249	44	21.5%
Maj	266	245	-21	-7.9%
Qershor	288	272	-16	-5.6%
Korrik	239	282	43	18.0%
Gusht	286	248	-38	-13.3%
Shtator	223	326	103	46.2%
Tetor	142	418	276	194.4%
Nentor	207	275	68	32.9%
Dhjetor	185	278	93	50.3%
TOTAL	2578	3355	777	30.1%



Përmirësimet operative

Gjatë vitit 2022 janë inicuar dhe futur në operim sisteme të reja që kanë qenë të përfshira në kuadër të projektit “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Nërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe projekte tjera të planifikuara dhe buxhetuara nga ASHNA.

Një ndër projektet më ambicioze të nisura këtë vit është sistemi ATM (Air Traffic Management).

Në vijim kemi paraqitur projektet kryesore të zhvilluara gjatë periudhës raportuese, si dhe detaje tjera përkatëse.



- Sistemi ATM (Air Traffic Management)
- Sistemi AIM “Aeronautical Information Management”
- Procedurat PBN “Performance Based Navigation”
- Sistemi Instrumental i Aterimit ILS Cat I per RWY 35
- Sistemi Instrumental i Aterimit ILS Cat III b per RWY 17
- Sistemi i radiokomunikimit VHF/UHF në dy lokacione, Goleshit dhe ASHNA
- Sistemi për inxhizim të zërit
- Sistemi AWOS për observim të motit
- Sistemi ATIS/VOLMET
- Sistemi për parashikim të motit
- Sistemi VCS Sitti në VOIP, integrimi i sistemit të ri të Radiokomunikimit në Golesh dhe ASHNA
- Furnizimi me pozita operuese të VCS Garex
- Procesimi i mesazheve AFTN (Kontrata me ISAVIA)
- Sistemi i radiokomunikimit në Gërmi
- Radari Mode S/I në lokacionin e Gjakovës
- Furnizim me shkallë për çasjen në platformën e radarit MSSR Mode S në Golesh
- Furnizim me pajisje të teknologjisë informative
- Furnizimi me bateri, instalimi dhe funksionalizimi i UPS-ve

Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)

Gjatë vitit 2022 kemi inicuar projektin Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM). Përgjatë kësaj periudhe raportuese, procesi i tenderimit është zhvilluar me dy shpallje dhe një anulim. Anulimi është bërë për arsye se ofertat nuk kanë qenë të përgjegjshme. Procesi i prokurimit vazhdon në vitin 2023.

“ATM System” ose ndryshe Sistemi i Menaxhimit të Trafikut Ajror është një term i aviacionit që përfshin të gjitha sistemet që ndihmojnë avionët të nisen nga një aeroport, hapësira ajrore transitore dhe të ulen në një aeroport për ku është nisur, duke përfshirë Kontrollin e Trafikut Ajror (ATC), Shërbimet e Trafikut Ajror (ATS), Menaxhimin e Hapësirës Ajrore (ASM), dhe Menaxhimin e Fluksit dhe Kapacitetit të Trafikut Ajror (ATFCM).

ATM-ët modern janë sisteme të ndërveprueshme dhe të harmonizuara që lejojnë një avion të operoi sigurtë, me ndryshimin minimal të performancës nga një hapësirë ajrore në tjetrën.


Qëllimi i këtij projekti është të përmbush kërkesat operative dhe teknike, nevojave që kanë dalë si rezultat i rihapjes së hapësirës së ulët ajrore dhe planeve për menaxhim të hapësirës së lartë ajrore.

Sistemi i ri i ATM do të mundësoi që të ndërrohen të gjithë serverët, duke e bërë kështu të mundshëm implementimin e “serviseve” të cilat me vështirësi po zbatohen në sistemin aktual të procesimit të dhënave. Sistemi i ri i ATM do të mundësoi gjithashtu një koordinim të qetë përmes implementimit të FDP-së dhe ndërlidhjes me fqinjët përmes shërbimit OLDI. Në këtë mënyrë do të rritet mundësia e menaxhimit më të sigurt të numrit më të madh të fluturakeve me normalizimin e hapësirës ajrore.

Qëllim tjetër i këtij projekti është që të argumentoi implementimin e një sistemi të ri të procesimit të të dhënave i cili do të bazohet në standardet më të larta ndërkombëtare të aviacionit civil. Këto standarde bazohen në dokumentet e organizatave ndërkombëtare të Aviacionit Civil-ICAO dhe Eurocontrol.

Në të njëjtën kohë me implementimin e këtij projekti do të zotoheshim dhe do argumentonim që hapësira ajrore e Republikës së Kosovës është një hapësirë e sigurt për operim sa i përket vrojtimit të fluturakeve dhe kontrollit të tyre.





Sistemi AIM (Aeronautical Information Management)

Në muajin prill të vitit 2022 është përfunduar dhe vënë në përdorim Sistemi për Menaxhimin e Informacionit Aeronautik – AIM System.

Transformimi nga AIS në AIM është kalimi prej informacionit aeronautik nga hartat tradicionale dhe publikimet në letër drejt informacionit dixhital aeronautik të bazuar në standarde në kohë reale. Shërbimet tradicionale të Informacionit Aeronautik (AIS) mbështesin operacionet e fluturimit duke ofruar botime të informacionit statik si Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP), Njoftimet për Aeroplanët (NOTAM, SNOWTAM, ASHTAM dhe BIRDTAM) dhe Informatat e Informacionit para fluturimit (PIB). Këto produkte tradicionale AIS janë krijuar për t'u prodhuar me dorë dhe për t'u konsumuar nga njerëzit dhe si rezultat, informacioni është i bazuar në tekst.

Meqenëse sistemi modern ATM bazohet në një mjedis vendimmarrës bashkëpunues, kjo e bënë te domosdoshme disponueshmërinë në kohë të informacionit aeronautik në format elektronik të cilësisë së lartë. ASHNA ka prokuruar dhe ka instaluar sistemin AIM nga prodhuesi Italian IDS AirNav, që është pjesë e grupit ENAV.

Komponentet kryesore të sistemit AIM janë:

Aero-DB Baza e të dhënave e bazuar në modelin e të dhënave AICM 5.1. I vendosur në një server

ku qasen klientë/sisteme të shumta. Ai përmban të gjitha të dhënat e gjeografisë ATS të rëndësishme për ANSP ndihmon prodhimin e AIP-se dhe grafikëve

CRONOS Është vegla që përdoret për menaxhimin e të ashtuquajturave të dhëna dinamike aeronautike (FPL, NOTAM, SNOWTAM, BIRDTAM, ASHTAM, PIB)

eTOD (Seti elektronik i të dhënave të terrenit dhe pengesave) është komponente e sistemit AIM (menaxhimi i informacionit aeronautik) për të menaxhuar të dhënat e aeroportit, terrenit dhe pengesave, duke siguruar përputhjen me kërkesat ndërkombëtare të cilësisë së të dhënave.

IAS Shërben për menaxhim të integruar të informacionit aeronautik. Ai ka një bazë të dhënash qendrore aeronautike (AeroDB) dhe një grup veglash për adoptimin e të dhënave si dhe për të importuar dhe eksportuar të dhëna.

ICE (Integrated Cartographic Environment) është një zgjidhje e bazuar në GIS (sistem informacioni gjeografik) për krijimin dhe mirëmbajtjen e tabelave aeronautike sipas udhërrëfyesit të ICAO për kalim nga AIS (shërbimet e informacionit aeronautik) në AIM (menaxhimi i informacionit aeronautik).

PLX Një aplikacion ueb dhe shërbime aplikacioni në ueb që përdoret për konfigurimin dhe ekzekutimin e Rrjedhës së Punës (workflow).

FPDAM Një mjedis dinamik CAD/GIS i zhvilluar posaçërisht për dizajnesit e procedurave të fluturimit me instrumente dhe hapësirave ajrore.

FPSAT Është një mjet për verifikimin dhe validimin në tokë të procedurave të fluturimit RNP/RNAV. Ai vlerëson performancën e GNSS dhe DME/DME përgjatë procedurës, kontrollon

kodimin e procedurës kundrejt kërkesave të ARINC424 dhe ndihmon në vlerësimin e fluturueshmërisë së procedurës duke marrë parasysh kodimin, parametrat e avionit dhe mjedisit.

Të gjithë zyrtarët përgjegjës për mirëmbajtje dhe përdorim të sistemit janë trajnuar për komponente apo aplikacione të sistemit.

Procedurat PBN “Performance Based Navigation”

Procedurat Performance Based Navigation (PBN) janë vënë në funksion më 11 gusht të vitit 2022. Këto procedura të bazuara në Global Navigation Satellite Systems (GNSS) dhe sistemet e tjera ekuivalente, do të jenë procedurat kryesore të navigimit ajror dhe shumë shpejt priten të zëvendësojnë procedurat konvencionale të fluturimit.

Procedurat PBN të përdorura në hapësirën ajrore të Kosovës kanë një saktësi të lartë navigacionale. Përpos aspektit të precizitetit, benefitet e përdorimit të procedurave PBN përfshijnë; shkurtimin e trajektoreve të fluturimit (rrugëtimin të fluturakeve për/nga destinacioni), gjë që ndikon drejtpërdrejt në shkurtimin e kohës të aterimit dhe ngritjes të fluturakeve, kursimit të karburanteve, zvogëlimin e emetimit të CO₂, shfrytëzimit më racional të hapësirës ajrore, uljen e kostos të mirëmbajtjes si dhe zvogëlimin e zhurmës në zonat e banuara.

Mbi 95% e kompanive ajrore të cilat fluturojnë në hapësirën ajrore të Kosovës, kanë fluturake dhe personel të cilët mund t'i aplikojnë procedurat PBN, po ashtu edhe ASHNA për aplikimin e këtyre procedurave, ka trajnuar në vitin 2022 të gjithë kontrollorët e trafikut ajror sipas standardeve të EASA, në institutin e trajnimeve GATE Aviation në Kopenhagë, Danimarkë. Pas vënies në funksion të procedurave konsiderohet që 95% e fluturakeve që fluturojnë për dhe nga BKPR janë duke i shfrytëzuar procedurat PBN. Këto procedura kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe në lehtësimin e punës të kontrollorit në detyrë.

Gjatë përdorimit të procedurave PBN është konstatuar edhe një detaj i cili nuk qenë i pranishëm në procedurat e vjetra konvencionale. Fluturaket në procedurat PBN për pistën 17 janë duke fluturuar shumë ulët mbi qytetin e Prishtinës dhe në disa raste edhe jozyrtarisht kemi pranuar ankesë nga qytetarët e Prishtinës për këtë gjë. Konsiderojmë se në të ardhmen duhen rishikuar trajektoret e procedurave PBN për pistën 17 dhe duhet të merret parasysh dizajnimi i trajektores pët të shmangur qytetin e Prishtinës.

Sistemi i radiokomunikimit VHF/UHF në Golesh dhe ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror për të realizuar komunikimin tokë-ajër ka të instaluar një sistem të radio komunikimit (VHF dhe UHF) i cili fizikisht është i vendosur në dy lokacione (Golesh dhe Aeroport). ASHNA operon me shërbime APP (Approach-Radar), GND (Ground) dhe TWR (Tower). Për të mbuluar këto zona të fluturimeve dhe për të komunikuar me fluturake që gjenden në këto zona, kontrollorët e trafikut ajror përdorin sistemin e radiokomunikimit tokë-ajër në frekuencë të caktuar. Ekzistojnë dy

lloje të frekuencave për këto zona, VHF dhe UHF. Frekuencat VHF janë frekuenca që i takojnë brezit civil të aviacionit dhe frekuencat UHF i takojnë brezit militar. Në kuadër të projektit për zgjatjen dhe ngritjen e kapaciteteve të pistës është paraparë edhe sistemi i ri i radiokomunikimit, i cili do të instalohet në lokacionet e njëjta (Golesh – Aeroport). Ky projekt është aprovuar nga AAC në qershor 2022 dhe tani është në funksion.

Furnizim me shkallë për qasje në platformën e radarit MSSR Mode S në Golesh

Radari i Goleshit është i vendosur në një konstrukcion metalik të lartë 15m dhe qasja te antena është bërë përmes disa shkallëve vertikale, që janë vlerësuar si të rrezikshme për sigurinë e personelit dhe gjithashtu joadekuate.

Për të siguruar qasje më të lehtë dhe më të sigurtë për personelin teknik, përmes këtij projekti kemi vendosur shkallë tjera përgjatë gjithë konstrukcionit.

Sistemi për inxhizim të zërit (VCR)

Sistemi VCR është një sistem i regjistrimit të komunikimit zanor që realizohet përmes sistemit të radiove dhe sistemit të telefonisë. Komunikimet të cilat regjistrohen nga sistemi VCR ruhen në sistem për një afat të caktuar, që sipas kërkesave ligjore është 30 ditë. Sistemi

mundëson nxjerrjen e ketyre regjistrimeve, nëse është e nevojshme të shfrytëzohen në proceset investiguese. Ky projekt është aprovuar nga AAC në qershor të vitit 2022 dhe tani është në funksion.

Sistemi ATIS/VOLMET

Është sistem që bën transmetimin e vazhdueshëm të regjistruar të raporteve për kushtet e motit të aeroporteve (aeroportit të vetëm të Kosovës) të zgjedhura për fluturaket gjatë fluturimit. Raportet që transmetohen janë: METAR/SPECI, TAF, SIGMET dhe AIRMET. Sistemi

VOLMET duhet të konfigurohet me burimin e të dhënave të motit përmes AFTN - it dhe pastaj gjeneron transmetimet VOLMET mbi një transmetues radio VHF.

Në korrik të vitit 2022 është aprovur nga AAC-ja.

Sistemi AWOS për observim të motit

Është sistem që bën transmetimin e vazhdueshëm të regjistruar të parametrave meteorologjik nga sensorët përgjat pistës, si era me shpejtësi dhe drejtim (në të dy pistat), temperatura dhe lagështia, shtypja e ajrit, dukshmëria dhe moti, dukshmëria në pistë,

matjen e bazës së reve etj. Ky sistem do të jetë pjesë përbërëse e ngritjes së kapaciteteve për ILS CAT IIIb.

Sistemi është futur në funksion në Korrik të vitit 2022.

Sistemi për parashikim të motit

Sistemi „Forecasting Workstation“ është sistem që përdoret për përgatitjen e parashikimeve meteorologjike aeronautike. Përmes këtij sistemi kontribohet në përgatitjen e produkteve si TAF, SIGMET, AIRMET, Cross Section, 7 Day Forecast, LAF PM & AM, Aerodrome Warning dhe Weather Warning si dhe produkte të tjera të veçanta të kërkuara nga shfrytëzuesit aeronautik.

Ky projekt është pjesë e projektit “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Nërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Eshte aprovuar nga AAC në dhjetor të vitit 2021 dhe është në funksion (duke u përdorur).

Sistemi i ri VCS Sitti dhe “upgrade” i VCS GAREX

Sistemi VCS është një sistem i cili mundëson komunikimin zanor në mes kontrolloreve të trafikut ajror dhe ekuipazhit të fluturakeve, si dhe me njësitë përkatëse të jashtme (OSHNA fqinje) dhe të brendshme (shërbimet tona operative). Sistemi VCS mundëson integrimin e të gjitha komunikimeve telefonike, “hotline” dhe radiove tokë - ajër (UHF dhe VHF) në një konsollë të vetme operative, nga e cila kontrollori i trafikut ajror mund t’i qaset më lehtë komunikimeve të tilla sipas nevojës dhe është bërë “Upgrade” i sistemit të VCS nga Garex për

të bërë të mundur adaptimin e sistemit të radiokomunikimit Golesh dhe ASHNA.

Për më shumë, përveç VCS SITTI (Primar) te SITTI dhe GAREX (Back-up), kemi instaluar edhe një radio sistem të pavarur për radiokominim (JOTRON).

Ky projekt është pjesë e projektit “Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Nërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Ky ndryshim është aprovuar nga AAC në vitin 2022 dhe është në funksion.

Procesimi i mesazheve aeronautike AFTN (lidhja me Islandë)

Për arsye të njohura, ASHNA menaxhimin e mesazheve aeronautike e bën përmes Islandës, duke këto mesazhe në rrjetin AFTN.

Ky sistem është i rëndësishëm primare për funksionimin e ASHNA-së, gjegjësisht të trafikut

ajror në Kosovë. Përmes këtij sistemi, mundësohet transmetimi dhe pranimi i të dhënave aeronautike në nivel global, të domosdoshme për menaxhimin e trafikut ajror.

Gjatë këtij viti, është lidhur marrëveshje për periudhë 3 vjeçare (2022 -2024) me ISAVIA


(Islandë), për procesimin e mesazheve aeronautike përmes sistemit AFTN.

Sistemi i radiokomunikimit në Gërmi

Sistemet e radiokomunikimit janë të vendosura në dy lokacione të ndara, Golesh dhe ASHNA. Frekuencat e TWR/GND gjenden fizikisht në objektin e ASHNA-se, ndërsa frekuencat e APP janë të lokalizuara në Golesh. Bazuar në studimet e zhvilluara për mbulueshmëri me radio në hapësirën ajrore të Kosovës, në funksion të përmirësimit të mbulueshmërisë me radio, lokacioni i Gërmisë është identifikuar si i përshtatshëm për vendosjen dhe instalimin e një sistemi të ri të radiove, në mënyrë që secila të ketë mbulueshmëri të dyfishtë.

Kontrata për punët civile lidhur me këtë projekt, që parashihte ndërtimin e objektit për vendosjen e sistemit/pajisjeve të radiokomunikimit në Gërmi, është anuluar në vitin 2022, meqenëse nuk është lejuar ndërtimin në atë zonë. Si rrjedhojë, është ndërruar lokacioni dhe është vendosur për një lokacion të ri në Gërmi (zonë e MPB), ku kemi vendosur “kontenjerë”, në të cilën do vendosen sistemet/pajisjet përkatëse.

Projekti i radiokomunikimit në Gërmi ka filluar në vitin 2018 dhe pritet të përfundojë në vitin 2023.



Projekti i MSSR Mode S (Gjakovë)

Gjatë vitit 2022 ka përfunduar instalimi i MSSR Mode S dhe konfigurimi i tij, i ashtuquajtur "fine tuning". Është përfunduar trajnimi i stafit dhe pranimit teknik në lokacion (SAT). Gjithashtu është zhvilluar edhe "flight check" –u (testimet nga ajri). Radari nuk është futur në funksion gjatë

këtij viti, për arsye se nuk është certifikuar nga AAC-ja.

Sipas procedurave përkatëse, ne kemi dërguar në AAC materialin në dispozicion, por Operatori Ekonomik - Leonardo gjatë periudhës raportuese nuk n'a ka dorëzuar (vonuar) dokumentacionin përkatës të kërkuar nga AAC-ja.

Furnizimi me pjesët rezervë për sisteme radarike

Kontrata për furnizimin me pjesë rezervë për sisteme radarike është lidhur në vitin 2019. Por deri tani, furnizimet janë realizuar vetëm në rreth 40% të vlerës së përgjithshme të kontratës. Në këtë çështje, kemi adresuar vazhdimisht ankesat dhe shqetësimet tona Operatorit Ekonomik – Leonardo, por pa rezultat gjatë kësaj periudhe raportuese.

Sistemi Instrumental i Aterimit ILS Cat III b për RWY 17

Në kuadër të projektit "Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Nërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" është instaluar Sistemi Instrumental i Aterimit ILS Cat III b për (pistën) RWY 17. Ky sistem mundëson operimin në kushte të dukshmërisë së zvogëluar deri në 50 m. Sistemi i mundëson fluturakes që

t'i afrohet pistës, të udhëhiqet nga pranuesi ILS i fluturakes, duke kryer krahasim në mes të thellësisë së modulimit. Një ILS përbëhet nga dy nën-sisteme të pavarura. Lokalizeri (LLZ) i cili ofron udhëheqje laterale dhe "glide slope" i cili ofron udhëheqje vertikale. Ky projekt është përfunduar në fund të vitit 2021 dhe është vënë në përdorim në vitin 2022, pasi është instaluar AWOS-i i ri.

Sistemi Instrumental i Aterimit ILS Cat I për RWY 35

Në kuadër të projektit "Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemeve të radiokomunikimeve në Aeroportin Nërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" është instaluar sistemi Instrumental i aterimit ILS Cat I për (pistën) RWY 35. Ky sistem i mundëson fluturakes që t'i afrohet pistës, të udhëhiqet nga pranuesi ILS - i fluturakes, duke kryer krahasim

në mes të thellësisë së modulimit. Një ILS përbëhet nga dy nën-sisteme të pavarura. Lokalizeri (LLZ) i cili ofron udhëheqje laterale dhe "glide slope" i cili ofron udhëheqje vertikale. Ky projekt është përfunduar në fund të vitit 2021 dhe është futur në përdorim në vitin 2022, pas certifikimit të PBN-it.

Furnizim me pajisje të teknologjisë informative

Për furnizim me pajisje të teknologjisë informative, janë zhvilluar dy aktivitete prokurimi. Në njërin aktivitet jemi furnizuar me kompjuterë, monitora, laptopa dhe “workstation” për stafin e ASHNA që i kanë pasur kompjuterët më të vjetër se 10 vite.

Në aktivitetin tjetër jemi furnizuar me disa pajisje tjera të rrjetit, që shërbejnë për funksionalizimin e komunikimit me radarin e Gjakovës dhe për ruajtjen e të dhënave të personelit në ASHNA. Të gjitha furnizimet kanë përfunduar sipas kërkesave tona teknike dhe brenda afateve të përcaktuara me kontratë.

Furnizimi me bateri, instalimi dhe funksionalizimi i UPS-ëve

Në kuadër të mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të sistemeve të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike, jemi pajisur me bateri të reja për dy sisteme dhe lokacione të ndryshme, Golesh dhe në ndërtesën e ASHNA-së.

Projekti është zhvilluar dhe realizuar gjatë vitit 2022 dhe ka mbuluar tërësisht nevojën e ASHNA-së për qëndrueshmeri dhe autonomi në furnizim me energji elektrike, në rast të dështimit të burimit primar me energji elektrike.

Koordinimi Civil-Ushtarak

ASHNA është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror edhe për trafikun ushtarak. Këto detyra zhvillohen në koordinim të ngushtë dhe të përhershëm me KFOR-in dhe autoritetet vendore. Në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve, gjate vitit 2022 janë zhvilluar dhe bashkërenduar një sërë aktivitete me të gjitha organet e sigurisë në vend, e në veçanti me FSK-në dhe KFOR-in.

Takime të rregullta janë mbajtur me FSK-në, MPB-në, KFOR-in dhe organet e tjera të sigurisë, për të cilat ASHNA edhe ka ofruar trajnimin lidhur me përdorimin e formës/ kërkesës për fluturimin e dronëve/ sistemeve të avioneve pa pilot (UAS).

ASHNA ka assistuar në vlerësimin e gjendjes fizike të aeroportit të Gjakovës, së bashku me FSK-në dhe kontraktorët e FSK-së.

ASHNA është zotuar në ofrimin e trajnimeve relevante në aviacion, për kërkesat e organeve të sigurisë.




Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë

Menaxhimi i Sigurisë

Siguria, apo niveli i lartë i sigurisë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, i ofruar nga ASHNA, ka prioritet mbi aspektin tregtar, operacional, social dhe çdo aspekt tjetër të biznesit. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) i ASHNA-së synon arritjen sistematike dhe proaktive të një niveli të pranueshëm sigurie, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar drejt sigurisë së trafikut ajror evropian në përgjithësi.

Komponenti kryesor i SMS-it është Manuali i Menaxhimit të Sigurisë, i cili përcakton organizimin dhe proceset e SMS-it, si dhe procedurat bazë të SMS-it, në mënyrë që të përputhet me kërkesat e SMS-it të përcaktuara në rregulloret kombëtare dhe standardet evropiane të sigurisë.

Matja e performancës së sigurisë dhe Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së sigurisë, na ndihmon të përmirësojmë nivelin e sigurisë dhe shërbimet tona në përgjithësi. Fushat kryesore të performancës së sigurisë së ASHNA-së janë në përputhje me rregulloret e zbatueshme të AACK-së.



“Just Culture”

Çelësi për zbatimin e suksesshëm të rregulloreve të sigurisë është të arrihet një mjedis raportimi “JUST CULTURE” brenda organizatave të aviacionit, rregullatorëve dhe autoriteteve të hetimit. Kjo kulturë efektive e raportimit varet nga mënyra se si organizata trajton fajin dhe ndëshkimin.

Koncepti “JC” ka për qëllim që të zhvillohet një kulturë në të cilën operatorët e linjës së parë dhe të tjerët nuk ndëshkohen për veprime, mosveprime ose vendime që kanë marrë dhe që janë në përpjesëtim me përvojën e tyre dhe trajnimin, ndërkohë që neglizhenca e rëndë, shkeljet e qëllimshme dhe aktet shkatërruese nuk tolerohen.

Në vazhden e ngritjes së kësaj culture, gjithnjë në interes të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe adaptimit të rregulloreve të BE-së, ASHNA ka implementuar “JUST CULTURE” si pjesë e Menaxhimit të Sigurisë.

Menaxhimi i Cilësisë

ASHNA ka implementuar Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (SMC) dhe është në proces për t'u certifikuar në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015.

ISO 9001:2015 SMC ndihmon në përmirësimin e performancës së përgjithshme dhe ofron një bazë solide për zhvillim të qëndrueshëm.

Cilësia e shërbimeve që ofron ASHNA, është e garantuar nga një grup i kontrollimeve dhe mbikëqyret nga menaxhmenti kompetent i projekteve, personat e autorizuar të cilit janë pjesë e proceseve të trajnimit dhe të zhvillimit të sistemit. Gjithashtu, cilësia e garantuar e shërbimeve i nënshtrohet kontrollave të rregullta të zhvillimit të dokumenteve të brendshme si dhe mirëmbahet pajtueshmëria e tyre me normat tjera të aplikueshme.

Gjatë periudhës raportuese, kontrolli i cilësisë është bërë gjithashtu edhe përmes auditimeve të brendshme, të cilat kanë ndihmuar në rishikimin e proceseve si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

Përveq mirëmbajtjes së sistemit ekzistues të Menaxhimit të Cilësisë, ASHNA gjatë vitit ka bërë progres në përgaditje për të siguruar certifikimin me ISO 9001:2015, finalizimi i të cilit planifikohet të arrihet gjatë vitit 2023.



Konsultimi me Shfrytëzuesit e Shërbimeve dhe Matja e Kënaqshmërisë

Duke u bazuar në Nenin 16, Paragrafi 1.12 i Ligjit Nr. 04/L 250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si të Rregullores Nr. 7/2012 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës mbi Kushtet për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, është zhvilluar një takim konsultativ me shfrytëzuesit e shërbimeve tona. Ky takim zhvillohet në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve tona, duke ndarë me shfrytëzuesit e shërbimeve informacione për planet zhvillimore të ASHNAs dhe për adresimin e çdo çështjeje me interes.

Po ashtu, në mbështetje të nenit 16, përkatësisht pikës 1.8, 1.12 dhe 1.13 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), kemi zhvilluar një anketim për matjen e Kënaqëshmërisë së Konsumatorit me Shërbimet e ASHNA-së për vitin 2022. Nga ky anketim rezulton se shfrytëzuesit e shërbimeve janë shumë të kënaqur me shërbimet e ASHNA-së.



Menaxhimi i Sigurimit

Sistemi i Menaxhimit të Sigurimit në ASHNA (SecMS) garanton sigurinë e punonjësve dhe personave të tjerë në ambientet tona, sigurinë e objekteve dhe pajisjeve teknike, për të parandaluar ndërhyrjet e paligjshme në ofrimin e shërbimit. ASHNA gjithashtu mbron të dhënat e biznesit të cilat i merr, prodhon ose përdorë. “SecMS” rregullohet nga Programi Kombëtar i


Sigurisë së Aviacionit Civil për Republikën e Kosovës. Synim i sistemit është parandalimi dhe veprimi në përputhje me Politikën e Sigurimit, ku masat e prezantuara nuk duhet të ngadalësojnë ose pengojnë në ndonjë mënyrë tjetër proceset tona kryesore të biznesit.




Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës

Raportimi i Hazardeve


Hazardet e raportuara – Periudha 01 Janar – 31 Dhjetor 2022					
Muaji	DATS	DTEK	DMET	DAIS	TOTAL/MUAJI
Janar	15	3	2	0	20
Shkurt	20	8	5	0	33
Mars	24	8	7	0	39
Prill	28	0	9	0	37
Maj	37	0	5	0	42
Qërshor	46	0	6	0	52
Korrik	76	0	14	0	90
Gusht	41	0	23	0	64
Shtator	23	3	35	0	61
Tetor	0	4	28	0	32
Nëntor	0	0	21	0	21
Dhjetor	0	0	16	0	16
TOTALI	310	26	171	0	507






Në përgjithësi, gjatë vitit 2022 në ASHNA janë regjistruar:


- **Ndodhi të kategorisë A (aksidente) – 0**
 - ✓ Të tjera – 6
- **Ndodhi të kategorisë B (incidente) –7**
 - ✓ Airspace Infringement – 1
 - ✓ TCAS EWG5712 – 1
 - ✓ Bomb Threat – 2
 - ✓ Wrong turn while taxiing – 1
 - ✓ Taxiway Incursion – 1
 - ✓ Runway Infringement – 1
- **Ndodhi të kategorisë B (zvogëlim i ndarjes) – 0**
- **Ndodhi të kategorisë C – 135**
 - ✓ Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM) – 1
 - ✓ Dështimi i funksionit të Navigimit – 4
 - ✓ Dështimi i funksionit të Survejimit – 0
 - ✓ Dështimi i funksionit të Komunikimit – 24
 - ✓ Dështimi i funksionit ndihmës të informimit – 49
 - ✓ Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave – 51
- **Ndodhi të kategorisë D – 57**
 - ✓ Birdstrike – 29
 - ✓ Lasser attack – 11
 - ✓ Airspace Infringement - 2
 - ✓ No contact from traffic – 1
 - ✓ PAPI Lights – 1
 - ✓ TWR beacon U/S – 1
 - ✓ Missing flight information – 1
 - ✓ Weather Avoidance – 1
 - ✓ Unauthorized Pushback – 1
 - ✓ Alert 1 GPX530 – 1
 - ✓ Tirana not answering phone line on timely manner – 1
 - ✓ Lightning Strike – 2
 - ✓ Late FPL from DAIS – 1
 - ✓ RWY insp. found birds on RWY-R2 intersection – 1
 - ✓ PAN-PAN – 1
 - ✓ Mosmarreveshje ne komunikim DATS (TWR)-DTEK (TELS1) – 1
 - ✓ Pressurization problem (N604BA) – 1



Krahasueshmëria 2016 – 2017 – 2018 – 2019 – 2020 – 2021-2022




Raportimet sipas muajve për vitin 2022



MOR "A"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
MOR "B" (inc)	0	0	0	1	1	2	0	2	1	0	0	0
MOR "B"(sepp. Loss)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
MOR "C"	9	15	14	9	9	12	23	9	10	7	6	12
MOR "D"	1	1	3	5	3	3	6	11	16	4	3	1

■ MOR "A" ■ MOR "B" (inc) ■ MOR "B"(sepp. Loss) ■ MOR "C" ■ MOR "D"

Raportimet sipas Departamenteve



MOR "A"	0	0	0	0
MOR "B" (inc)	7	0	0	0
MOR "B"(sepp. Loss)	0	0	0	0
MOR "C"	81	28	6	62
MOR "D"	57	1	0	0

■ MOR "A" ■ MOR "B" (inc) ■ MOR "B"(sepp. Loss) ■ MOR "C" ■ MOR "D"

Caqet dhe treguesit kyç të performansës së Sigurisë për vitin 2022

Nr	Indikatori	Totali 2022	Totali 2021	Treguesi i sigurisë	Caqet e performansës së sigurisë për vitin 2022
1	Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)	8	6	Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)	Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 incidente në vit
2	Dështimi i funksionit të Navigimit	4	8	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 5 dështime në vitin 2022.
3	Dështimi i funksionit të Survejimit	0	19	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 5 dështime apo 94 orë në vitin 2022, përfshi këtu edhe ndërprerjet për mirëmbajtje të planifikuar
4	Dështimi i funksionit të Komunikimit	24	32	Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 15 dështime në vitin 2022
5	Dështimi i funksionit ndihmës të informimit	49	17	Numri i dështimeve të funksionit Ndhmës të informimit duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të funksionit ndihmës të informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 25 dështime në vitin 2022
6	Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave	51	20	Numri i dështimeve të funksionit procesimit të të dhënave duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhive të dështimit të funksionit të Procesimit të të dhënave me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 7 dështime në vitin 2022
7	Të tjera	6	7	Numri i dështimeve tjera duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhive të dështimit të funksioneve tjera me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 në vitin 2022.
Totali		142	109		

Krahasimi i treguesve të performancës 2016 – 2022

Nr	Indikatori	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016
1	Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)	8	6	0	7	7	7	5
2	Dështimi i funksionit të Navigimit	4	8	4	2	2	2	1
3	Dështimi i funksionit të Survejimit	0	19	7	18	5	1	20
4	Dështimi i funksionit të Komunikimit	24	32	19	11	9	14	6
5	Dështimi i funksionit ndihmës të informimit	49	17	13	23	35	24	16
6	Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave	51	20	9	9	5	7	10
7	Të tjera	6	7	6	4	2	7	5
TOTALI		142	109	58	74	65	62	63

Arsyeshmëria për rritjen e ndodhive të raportuara

Nga tabela e caqeve dhe treguesve kyç të performancës së sigurisë për vitin 2022 (aneksi 01 i këtij raporti), vërehet se në kategorinë C ka rritje në numrin total të raportimeve në krahasim me vitet paraprake apo i kanë tejkaluar caqet e planifikuara. Në kategorinë D të raportimeve në krahasim me vitin paraprak vërehet një rënie e lehtë.

Në fushën e **funksionit të navigimit**, ka rënie në krahasim me vitet paraprake dhe nuk është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar.

Në fushën e **funksionit të survejimit**, ka rënie në krahasim me vitet paraprake dhe nuk është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar.

Në fushën e **funksionit të komunikimit**, ka rënie nga viti paraprak dhe nuk është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Vlen të theksohet se është instaluar sistemi i ri i radiove në Golesh dhe ASHNA dhe pritet që në fillim të vitit 2023 të instalohet edhe një sistem i ri në Germi.

Në fushën e **funksionit ndihmës të informimit**, ka rritje në krahasim me vitin e kaluar, dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Ndodhitë kryesisht janë rritur pas instalimit të sistemeve të reja meteorologjike, të cilat sipas prodhuesve duhet pak kohë deri në stabilizimin e tyre. Këtu përfshihen sistemet AWOS (main dhe backup) dhe sistemet e parashikimit.

Në fushën e **funksionit të procesimit të të dhënave**, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Në këtë fushë gjendja është jo e mire, sistemi ATM është i vjetër (i instaluar në vitin 2004) dhe ka vështirësi në procesim të të dhënave. Për më shumë, rritja gjithnjë e më e madhe e trafikut ajror, po e vështirëson edhe më shumë procesimin e të dhënave. Si rrjedhojë e kësaj kanë ndodhur restartime të pozitive operuese duker shkaktuar humbje të fotografisë së

radarit si dhe humbje dhe devijime të objekteve në radar (radar targets). Në lidhje me këtë çështje, DCSS së bashku me DATS, kanë realizuar një vlerësim të sigurisë në vitin 2021 për t'u siguruar që performanca e sigurisë së operimeve, në ASHNA nuk do të ndikohet gjatë ofrimit të shërbimeve radarike.

ASHNA është në process të prokurimit të një sistemi të ri ATM dhe nëse gjithçka shkon sipas planifikimeve, brenda 3 viteve sistemi i ri do të instalohet. Në ndërkohë, janë duke u bërë përpjekje maksimale për mbajtjen në funksion të sistemit aktual.

Në fushën e **Incidenteve me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)** ka rritje në krahasim me vitin e kaluar, mirëpo nuk është tejkalluar caku i performansës së përcaktuar. Në këtë fushë, në rritje të numrit të ndodhive ka ndikuar edhe një dukuri e shfaqur në vitin 2022, ajo e kërcënimeve me bombë, të cilat për fat të mirë kanë rezultuar të jenë alarme të rrejshme.

Duhet theksuar se edhe ngritja e nivelit të vetëdijësimit të personelit për raportime, duke pasur parasysh angazhimin e menaxhmentit në fuqizimin e “No Blame Policy” dhe prezentimin e “Just Culture”, ka ndikuar në rritjen e raportimeve, gjithmonë në funksion të identifikimit dhe përmirësimit të zbrastësirave të mundshme, si dhe ngritjes së kapaciteteve, me qëllim të ngritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë.

Monitorimi i performancës

Të gjithë objektivat e indikatorëve kyç të performancës (KPI) të përcaktuara në planin e performancës për vitin 2022 janë përmbushur dhe tendencat në treguesit e performancës që po monitorohen janë pozitive.

FUSHA E PERFORMANCËS SË SIGURISË

Safety KPI #1: Level of Effectiveness of Safety Management Shkalla e Efikasitetit të Menaxhimit të Sigurisë									
		2022	2023	2024	2025	2026	2027		
		Vlera	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektivi		
Objektivat fillestare të performances (Initial Performance Target Setting)	ASHNA (Objektivat e menaxhmentit për kulturën e sigurisë)	C	C	D	D	D	D		
	ASHNA (për të gjitha objektivat tjera të menaxhmentit)	D	D	D	D	D	D		
	Përshkrimi i përputhjes së objektivave të ASHNA-së me ato kombëtare	Objektivat e ASHNA-së, janë në përputhje me ato kombëtare							
	Arsyeshmëria e detajuar ne rast të mospërputhjes								

Safety KPI #2: Aplikimi i shkallës së klasifikimit bazuar në metodologjinë (RAT) Risk Analyses Tool							
Ground Score		2022 Vlera	2023 Objektivi	2024 Objektivi	2025 Objektivi	2026 Objektivi	2027 Objektivi
ASHNA (Objektivi I performancës)	SMIs	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	RIs	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	ATM-S	100%	100%	100%	100%	100%	100%
Përshkrimi i përputhjes së objektivave të ASHNA-së me ato kombëtare		Në nivel të ASHNA-së, objektivat janë në përputhje me ato kombëtare					
Arsyeshmëria e detajuar ne rast të mospërputhjes							

Komentet shtesë

Objektivat janë kalkuluar duke konsideruar të dhënat historike për vitet 2013-2022.

Vonesat janë matur nëpërmjet numrit total të fluturimeve të vonuara, minutat totale të vonesës, numrit të vonesave për fluturim ose për fazë të fluturimit, ose kohëzgjatjes mesatare të vonesës për fluturim apo për fluturimin e vonuar, pas vendosjes së një sistemi softuerik gjithëpërfshirës për menaxhimin e trafikut ajror.

Capacity KPI #2: ASHNA ATFM VONESAT AEROPORTUALE DHE TERMINALE NË ARDHJE PËR FLUTURIM

		2022	2023	2024	2025	2026	2027
		Vlera	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektivi	Objektivi
Niveli kombëtarë	Objektivi fillestar i performancës	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)

Numri i aeroporteve Brenda fushëveprimit të planit të performancës	1
--------------------------------------------------------------------	---

ASHNA	ASHNA - BKPR (Prishtina International Airport)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)	2.5 (min/flu turim)
	Kontributi i aeroporteve në planin e performancës	Pasi që ka vetëm një aeroport në Kosovë, kontributi i aeroportit në lidhje me vonesat në nivel kombëtarë është 100%					

Komente shtesë	
<p>Për momentin Kosova nuk është pjesë e Menaxhimit të Rrjetit (Network Manager), dhe si rrjedhojë nuk bën pjesë në rregulloren e ATFM për alokim të vendit/sllotit. Për këtë arsye, AAC e Kosovës për momentin nuk pranon të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit. Vonesat e fluturimeve për fluturake në aeroport dhe terminal të ANS ATFM definojnë si në vijim:</p> <p>“Mesatarja e kohës së vonesës së arritjes që i atribuohen shërbimeve për navigim ajror dhe shërbimeve terminale dhe që shkaktohen nga restriksionet gjatë aterimit në aeroportin e destinimit, definojnë si në vijim:</p> <p>(i) treguesi është mesatarja e gjeneruar e vonesës nga ATFM vonesa për çdo fluturim IFR;</p> <p>(ii) treguesi i mbulon të gjitha fluturimet IFR që aterojnë në aeroportin e destinacionit dhe të gjitha shkaqet e vonesës ATFM, me përjashtim të ngjarjeve të jashtëzakonshme;</p> <p>(iii) treguesi llogaritet për tërë vitin kalendarik dhe për çdo vit të periudhës referuese.”</p> <p>Për më shumë, treguesi kalkulohet për rrjedhën e fluturimeve hyrëse që arrijnë në aeroport, përfshin një pjesë të vonesës para nisjes e cila shkaktohet nga kufizimet e aterimit në aeroportin e destinimit.</p>	

Duke patur parasysh definimin e shkruar më lartë, pa të dhëna nga Menaxheri i Rrjetit, është e pamundur të llogaritet historiku i saktë i kësaj mesatareje të KPI.

Deri më tani, NSA e Kosovës në bashkëpunim me ASHNA-në e Kosovës ka shiquar të dhënat e të kaluarës që ruhen lokalisht, të cilat bazohen në **alokim vendi/slot në aeroport procedurë lokale, koha e përafërt e arritjes (ETA)** (për të gjitha fluturimet hyrëse) dhe **koha e saktë e arritjes**. *Keni parasysh, alokimi i vendit në aeroport procedurë lokale nuk kryhet në koordinim me menaxherin e Rrjetit*. Si rrjedhojë, dy lloje vonesash të përsëritura janë kalkuluar për fluturimet ateruese:

1) në lidhje me alokimin e vendit në aeroport, si diferenca (në minuta) në mes të ATA dhe slotit, dhe

2) referuar ETA, si ndryshim (në minuta) mes kohës ATA dhe ETA.

Sidoqoftë, shkak që slotet nuk janë të kordinuara, lloji i parë i vonesës rezulton në vlera të mëdha vonese për fluturim. Kjo për shkak që, një vonesë e tillë mbulon vonesen e përgjithshme të fluturimit që mund të përfshij: vonesa të shkaktuara në aeroportin e nisjes, vonesat gjatë rrugës si dhe vonesat në aeroport dhe fazën e fundit.

Lloji i dytë i vonesës rezulton me vlera shumë më të vogla, pasi që i mbulon vetëm vonesat e shkaktuara mes kohës kur fluturimi kordinohet/transferohet mes njesive të ATC'së.

Në mënyrë që të kemi një vlerë njëjës të vonesës, **ne kemi zgjedhur të përdorim një mesatare të kapshme** të dy llojeve të vonesës. Shkak që, siç e përmendem slotet nuk kordinohen, është mendim i yni që lloji i dytë i vonesës është më i përafërt me vonesen reale të ATFM's. Si rrjedhojë ne i kemi caktuar një vlerë prej 20% vonesës së parë dhe 80% vonesës së dytë. Vlera mesatare e vonesës së 2 viteve të mëparshme është caktuar si synim për vitin në vijim, pasi që nuk priten zhvillime të mëdha.

Keni parasysh, pasi që BKPR për momentin nuk ka limite në kapacitet, ne nuk presim që vonesa mesatare të shënoj rritje me rritjen e numrit të trafikut. Duke shiquar të dhënat e së kaluarës, vonesat mesatare shkaktohen ose janë gjatë sezonit të dimrit, ne mund të vijmë në përfundim që shumica e vonesave lokale janë si shkak i motit të ligë, në veçanti mjegullës së dendur në afërsi dhe rreth aeroportit.

Me instalimin e pajisjeve të reja për aterim ILS (CAT IIIB për pistën 17 dhe CAT I për pistën 35), dy sistemeve të reja AWOS, si dhe me planet për ri-hapje të korridoreve të reja ajrore, ne presim që vonesat mesatare do të zvogëlohen në vitet në vijim.

Vëmendje: Kjo pjesë e planit mund të ndryshojë në vitet në vijim, nëse Kosova merr të dhënat direkt nga Menaxheri i Rrjetit.

Performanca Financiare

Njësitë e shërbimeve terminale

Nr	Muaji	Realizimi 2021	Realizimi 2022	ndryshimi	ndryshimi ne %
1	Janar	731	1,023	292	39.95%
2	Shkurt	483.84	695.3	211.46	43.70%
3	Mars	523.54	877.31	353.77	67.57%
4	Prill	453.38	1,258.94	805.56	177.68%
5	Maj	677.87	1,182.11	504.24	74.39%
6	Qershor	884.15	1,264.18	380.03	42.98%
7	Korrik	1,798.00	1,738.43	-59.57	-3.31%
8	Gusht	1,941.22	1,691.65	-249.57	-12.86%
9	Shtator	1,033.00	1,193.02	160.02	15.49%
10	Tetor	947.85	1,038.59	90.74	9.57%
11	Nentor	712.66	862.04	149.38	20.96%
12	Dhjetor	1,060.98	1,089.16	28.18	2.66%
Totalet		11,247.49	13,913.73	2,666.24	23.71%

Në vitin 2022, ASHNA ka pasur ngritje të theksuar të njësive terminale të shërbimit krahasuar me vitin 2021 në lartësi prej 23.71%.

Gjatë vitit 2022 janë ofruar gjithsej 13,913.73 njësi shërbimi.

Kostoja e njësisë

Llogaritja e kostonë së njësisë terminale të navigacionit (TNC) për vitin 2022 ka rezultuar nga zbatimi i metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2016 të AAC-së mbi përcaktimin e skemës së përbashkët

të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Bazuar në këtë metodologji, TNC llogaritet për vitin "n" në bazë të kostove dhe trafikut të vlerësuar për atë vit.

Kostoja e njësisë në vitin 2022 ka qenë 418 Euro.

Deklarata

Pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullësi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2022.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 të institucionit **Ajencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror**.

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave 2022

Nr	Muaji	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Ndryshimi
1	Janar	350,065.08	427,746.57	77,681.49
2	Shkurt	278,753.97	290,745.35	11,991.39
3	Mars	330,191.31	366,829.56	36,638.25
4	Prill	404,397.46	525,952.70	121,555.24
5	Maj	389,857.03	494,127.90	104,270.87
6	Qershor	415,137.28	527,942.93	112,805.65
7	Korrik	581,183.69	726,667.41	145,483.72
8	Gusht	611,158.37	707,119.52	95,961.15
9	Shtator	436,321.81	498,681.73	62,359.92
10	Tetor	373,523.04	434,130.95	60,607.91
11	Nentor	317,776.49	360,421.53	42,645.04
12	Dhjetor	401,634.46	455,270.64	53,636.18
	Totali	4,890,000.00	5,815,636.79	925,636.79

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

Shënim	2022	2021 -1	2021 -2
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	BKK '000	BKK '000	BKK '000
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET			
Granti qeveritar	1,453	1,172	2,203
Të hyrat vetanake			
Të hyrat e dedikuara	4,069	4,231	2,473
Grantet e përcaktuara të donatorëve			
Financimet nga huamarrja			
Klauzola e investimeve			
Fondi zhvillimor në mirëbesim			
Pranimet tjera			
Gjithsej	5,522	5,403	4,676
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT			
Operacionet			
Paga dhe shtesa	2 2,912	2,854	2,757
Mallra dhe shërbime	3 1,179	1,030	772
Shpenzime komunale	4 93	84	54
	4,183	3,968	3,583
Transferet			
Transfere dhe subvencione	5		
Shpenzime kapitale			
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6 1,339	1,435	1,843
Pagesa tjera	7		
Gjithsej	5,522	5,403	5,426

Shënim: Gjate vitit 2022 në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale janë përfshire edhe shpenzime në vlerë prej 67,080.93 Euro të cilat janë tërhequr nga Thesari me Urdhër përmbartimor, si dhe nga kategoria mallra dhe Shërbime në vlerë prej 8,447.22 të cilat kanë qenë obligime të Aeroportit Ndërkombëtar te Prishtinës “Adem Jashari” nga procese të mëhershme gjyqësore.

Raporti i ekzekutimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

Shënime	2022				2022 -1	2022 -2
	Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
	A € '000	B € '000	C € '000	D=B-A € '000	E € '000	F € '000
HYRJA E PARASË SË GATSHME						
Të hyrat tatimore	8			-		
Të hyrat jo tatimore	9	8		(8)		
Të hyrat e dedikuara	10	5,888	4,500	(1,388)	4,645	2,473
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11			-		
Tjera	12			-		
Gjithsej Pranimet		5,896	4,500	(1,396)	4,645	2,473
DALJA E PARASË SË GATSHME						
Paga dhe shtesa	2	2,912	2,912	2,798	0	2,854
Mallra dhe shërbime	3	1,179	1,468	1,490	289	1,030
Shpenzime komunale	4	93	112	112	20	84
Transfere dhe subvencione	5			-		
Shpenzime kapitale	6	1,339	1,668	1,833	329	1,435
Rezerva				-		
Tjerat	7			-		
Gjithsej pagesat		5,522	6,161	6,232	639	5,426

Shënim: Tek hyrja e parasë së gatshme, kemi një të hyrë jo tatimore në vlerë 8,492.52 për blerjen e banesës sipas pajtimit gjyqësorë Cnr.249/18 me datën 14.12.2022 e cila ka dal në fondin 10 të Buxhetit të Kosovës.

Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFP								Buxheti	Ndryshimet e
	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit) € '000	Ndryshimi I € '000	Ndryshimi II € '000	Ndryshimi III € '000	Ndryshimi IV € '000	Të hyrat vetanake € '000	Grantet e percaktuara te donatoreve € '000	Burime tjera te financimit € '000	përfundimtar SIMFK € '000	buxhetit fillestar € '000
Hyrjet										
Të hyrat tatimore								-	#DIV/0!	
Të hyrat jo tatimore								-	#DIV/0!	
Të hyrat e dedikuara	4,500							4,500	-	
Grantet e percaktuara të donatorëve								-	#DIV/0!	
Huamarrjet								-	#DIV/0!	
Tjera								-	#DIV/0!	
Gjithsej	4,500	-	-	-	-	-	-	4,500	-	
Daljet										
Paga dhe Shtesa	2,798		114					2,912	4%	
Mallra dhe shërbime	1,490	(22)						1,468	-1%	
Shpenzime komunale	112							112	-	
Transfere dhe subvencione								-	#DIV/0!	
Shpenzime kapitale	1,833	22		(186)				1,668	-9%	
Rezerva									#DIV/0!	
Kthimi i huamarrjeve								-	#DIV/0!	
Tjerat								-	#DIV/0!	
Gjithsej	6,232	-	114	(186)		-	-	6,161	-1%	

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Me Ligjin e buxhetit Nr. 07/L-041 për vitin 2022, Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror-ASHNA-së, ndarje të mjeteve financiare për vitin 2022 i janë bërë në total 6,232,438.25€.

Me datën 22.09.2022 kemi pasur transfer nga mallrat dhe shërbimet në kategorinë e projekteve kapitale në vlerë prej 21,612.45.

Me date 07/11/2022, ne baze te vendimit te Sekretariatit ZKM 286/2022 janë tërhequr nga projektet kapitale 185,729 EUR.

Me Vendimin e qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 04/115 22.12.2022 kursime ndarje dhe harmonizim i pagave është bërë ndryshimi tjetër dhe ASHNA-s i është shtuar buxheti për vlerën 114,000 Euro në kategorinë e Pagave

Shënimi 2 Paga dhe shtesa

Përshkrimi	2022									2022-1	2022-2	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi
	Pagesat	FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD	Final			Buxheti - Pagesat
€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	
Pagat neto përmes listave të pagave	2,421				95		2,325		2,421	-	2,371	2,251
Pagesa për sindikate	8				0		8		8	-	11	11
Anëtarësim - oda e infermierëve të Kosovës										-		
Anëtarësim - oda e mjekëve të Kosovës										-		
Pagesa neto - pune jashtë orarit										-		
Punëtoret me kontrate (jo në listën e pagës)										-		
Tatimi ndalur në të ardhurat personale	205				8		197		205	-	200	209
Kontributi pensional - punëtori	139				5		133		139	-	136	143
Kontributi pensional - punëdhënës	139				5		133		139	-	136	143
Pagesa për vendime gjyqësore	-						-		-			
Paga dhe shtesa	2,912	-	-	-	114	-	2,798	-	2,912	100%	2,854	2,756

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Në kategorinë Paga & Mëditje, shpenzime të periudhës Janar – Dhjetor 2022 gjithsejtë kemi 2,911,551 € ndërsa janë të planifikuar 2,798,003.25 dhe në Dhjetor 2022 ASHNA ka pranuar grant qeveritar në këtë kategori 114,000€.

Nga fondi 23 janë për këtë kategori janë shpenzuar 2,797,550.76 ndërsa nga fondi 10 janë shpenzuar 114,000.00

Pagat neto përmes listës se pagave2,420,563.63 €,

Pagesa për sindikate 8,486.88€,

Tatimi ndaluar në të ardhura personale..... 205,231.45 €,

Kontributi pensional - punëtori.....138,634.40 €,

Kontributi pensional - punëdhënësi..... 138,634.40 €,

Realizimi i buxhetit te kjo kategori gjatë vitit fiskal 2022 është 104%.

Mallra dhe shërbime

Përshkrimi	2022								Buxheti Final € '000	Ndryshimi Pagesat € '000	2022-1 € '000	2022-2 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000				
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	50						50	64	14	14	12	
Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	95						95	65	-30	52	25	
Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	95						95	79	-16	42	5	
Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	18						18	10	-8	13	3	
Shpenzimet per internet								1	1	1	0	
Shpenzimet e telefonisë mobile	11						11	11	-1	13	11	
Shpenzimet postare	1						1	3	2	0	0	
Shpenzimet për përdorimin e kabllit optik	10						10	40	30	4	0	
Shërbimet e arsimit trajnimit	326						326	369	43	223	382	
Shërbime të ndryshme shëndetësore	31						31	9	-22	4	2	
Sherbime shtypje-jo marketing	4						4	5	1	5	3	
Sherbime kontraktuese tjera	68						68	128	60	103	70	
Sherbime teknike	21						21	41	20	24	17	
Shpenzimet per anetaresim	13						13	13	0	13	13	
Mobilje (me pak se 1000 euro)	8						8	10	2	6	0	
Furnizim zyre	7						7	7	0	3	2	
Furnizim me ushqim dhe pije	8						8	11	2	3	3	
Furnizime pastrimi	6						6	8	2	3	4	
Furnizim me veshembathje	7						7	5	-2		-	
Vaji	3						3	7	4	1	0	
Derivate per gjenerator	1						1	5	4	1	3	
Karburante per vetura	21						21	14	-7	13	9	
Avanc per udhetime zyrtare									0	-	0	
Regjistrimi i Automjeteve	1						1	3	2	1	1	
Sigurimi i Automjeteve	5						5	5	0	7	0	
Taksat Komunale	0						0	1	1	0	0	
Sigurim i ndertesave	150						150	123	-27	244	94	
Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjeteve	9						9	8	0	6	3	
Mirëmbajtja e ndertesave	21						21	15	-6	8	4	
Mirëmbajtja e Teknologjise Informative	34						34	27	-7	2	9	
Mirëmbajtja e Mobiljeve dhe Paisjeve Tjera	134						134	362	228	103	38	
Mirëmbajtja Rutinore	8						8	6	-2	10	4	
Reklama dhe konkurset								4	4	-		
Botimet e Pubikimeve								5	5	-	0	
Shpenzimet per Informim Publik	0						0	2	2	0	-	
Drekat Zyrtare	5						5	5	0	6	2	
Vendime gjyqesore	8						8		-8	101	50	
Mallra dhe shërbime	1,179	-	-	-	-	-	1,179	-	1,468	289	1,030	772

Shpenzime komunale

Përshkrimi	2022									Ndryshimi Buxheti - Pagesat	2022-1	2022-2	
	Gjithsej	Buxheti							Final				
	Pagesat	FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD	Final				
€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		
Rryma	71							71		88	17	64	43
Uji	1							1		1	0	1	1
Mbeturinat	0							0		2	1	0	0
Ngrohja Qendrore	11							11		15	5	10	7
Shpenzimet telefonike	10							10		7	(3)	9	3
Pagesa-vendimet gjyqësore	-							-		-	-	-	-
Shpenzime komunale	93	-	-	-	-	-	-	93	-	112	20	84	54

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror shpenzime të kësaj kategorisë ka bërë shpenzime bazuar në faturat e furnizimit për shpenzimet e krijuara gjatë vitit fiskal 2022, që janë të përfshira, shpenzimet e energjisë elektrike, uji, mbeturinat, ngrohja, shpenzimet e telefonisë fikse.

Shpenzime kapitale

Përshkrimi	Gjithsej								Buxheti	Ndryshimi	2022 -1	2022 -2
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	Buxheti - Pagesat € '000	€ '000	€ '000
Ndërtesat e banimit									-			
Ndërtesat administrat. afariste	136.52				136.52				143	6	59	142
Objektet arsimore										-		
Objektet shëndetësore										-		
Objektet kulturore										-		
Objektet sportive										-		
Objektet memoriale										-		
Rrethoja										-		
Mobilje										-		32
Garazha										-		
Softwer										-	501	
Ndërtimi i auto rrugëve										-		
Ndërtimi i rrugëve regionale										-		
Ndërtimi i rrugëve lokale										-		
Trotuaret										-		
Kanalizimi									-	-		
Ujësjellësi									-	-		
Mirmbajtja investive										-		
Furn.me rrym.gjenimitransmis										-		
Paisje të teknologjis inform	88.71				88.71				90	1	150	18
Pagesa - Vendimet Gjyqsore										-	89	292
Vetura Zyrtare										-		
Pajisje Hardwer	601.28				601.28				601	0		
Vendime te gjykates	67.08				67.08				67	-		
Paisje tjera	445.40				445.40				767	322	635	1,359
Shpenzime Kapitale	1,339.00	-	-	-	1,339.00	-	-	-	1,668	329	1,434	1,843

Të hyrat e dedikuara

Përshkrimi	Shënime	2022	2022 -1	2022 -2	% e totalit 20__	% e ndryshimit nga 20__ -1
		€ '000	€ '000	€ '000		
Lloji i të hyrës 1		5,888	4,645	2,473		
Lloji i të hyrës 2					%	%
Lloji i të hyrës 3					%	%
Lloji i të hyrës 4					%	%
Gjithsej		5,888	4,645	2,473	0%	%

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Të hyrat e ASHNA-së krijohen në bazë të dhënies së shërbimeve për shfrytëzuesit e tyre ku tarifohen për këto shërbime në bazë të Ligjit Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, dhe menaxhohen në bazë të LMFPP. Të hyrat e ASHNA-se përbëhen nga : Tarifat e shfrytëzuesve të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA dhe Donacionet, grantet dhe çdo mbështetje tjetër financiare ose teknike e dedikuar për ASHNA-në.

Të dhënat e paraqitura në Shënimin 10 të hyrat e dedikuara janë sipas ofrimit të shërbimeve gjatë vitit fiskal 2022 ku në total të hyra gjatë vitit 2022 janë 5,887,646.94 EUR.

Duhet cekur që në vlerën 5,887,646.94 të të hyrave, përveç të hyrave nga shërbimet janë katër fatura të cilat ASHNA ka paguar për LIMAK ndërsa LIMAK ka kompenzuar ato mjete në llogarinë e ASHNA-së.

ASHNA çdo vit nënshkruan një kontratë për shërbimet e kalibrimit nga ajri, dhe në bazë të kësaj kontrate janë dy shërbime PAPI 17/35 të cilat shërbime i merr LIMAK, ku ASHNA kryen pagesën kompanisë së kontraktuar për të gjitha shërbimet pastaj LIMAK i kompenzon ASHNA-së, dhe gjatë vitit 2022 janë katër fatura në vlerë 15,860 që janë kompenzim nga LIMAK.

Të arkëtueshmet

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2022	2022-1	2022-2
50401	Shitja e shërbimeve	426,366.56	884,378.30	711,232.57
Gjithsej		426,366.56	884,378.30	711,232.57

Numri i faturës	Kodi ekonomik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	2022
00003/2022	50401	30 ditë	HUNGARO CONTROL	Air Ground communication Service 01 January to 31 March 2022	12,501.00
000004/2022	50401	30 ditë	HUNGARO CONTROL	Provision of Radar data 16 July to 15 october 2021	28,442.03
00006/2022	50401	30 ditë	HUNGARO CONTROL	Provision of Air Ground Communication Service 01 July to 30 September 2022	12,501.00
00005/2022	50401	30 ditë	HUNGARO CONTROL	Provision of Air Ground Communication Service 01 April to 30 June 2022	12,501.00
0017/2022	50401	30 ditë	LIMAK	Shërbimet ApprocheFee Nëntor 2022	360,421.53
					426,366.56

Detyrimet (faturat) e papaguara

Kategoria ekonomike	2022		2022-1		2022-2	
	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
Paga dhe shtesa						
Mallra dhe shërbime			1,525		13,549	
Shpenzime komunale						
Transfere dhe subvencione						
Shpenzime kapitale			41,346		63,755	
	<u>-</u>	<u>0</u>	<u>42,871.49</u>	<u>0</u>	<u>77,304.35</u>	<u>0</u>

Detyrimet kontingjente

		Vlera e vlerësuar ose e saktë		
		2022	2022 -1	2022 -2
Kategoria ekonomike	Kategoritë ekonomike			
11	Paga dhe shtesa	650,532.48	549,249.40	540,000
13	Mallra dhe shërbime			
14	Shërbimet komunale			
20	Subvencione dhe Transfere			
30	Shpenzimet kapitale			152,000
Gjithsej		650,532.48	549,249	540,000

Detyrimet kontingjente të ASHNA-së të vlerësuara:

Varësisht nga proceset e vlerësuara, janë të ndara tri kategori te vlerësimeve)

1. Vlerat e vlerësuara

- Lënda e Kontrolloreve të Trafikut Ajror me C.nr 635/14, numri i lendes 2019:161963, date 25/11/2022, Aktgjykimi i datës 08/11/2022 me vlere te kontestit prej 589,800.65 EUR, ne emër te pagesës shtese te pagave për pune gjate fundjavës duke vendosur ne lidhje me ankesën e ASHNA te ushtruar kundër aktgjykimit te Gjykatës Themelore ne Prishtine – Dega Lipjan, i datës 03/07/2019.

Ne këtë aktgjykim ku është përfshirë edhe kamata vjetore prej 8% duke filluar nga data 03/07/2019 deri te pagesa definitive si dhe shumen prej 9,882.50 Euro ne emër te shpenzimeve kontestimore, ne afat prej 15 ditësh nga dorëzimi I aktgjykimit , nen kërcënimin e përmbartimit te dhunshëm.

Me date 24/01/2023 ASHNA është njoftuar nga Avokatura Shtetërore e Kosovës për pranimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe po ndaj të njëjtit i është kërkuar ushtrimi i Mjetit të Jashtëzakonshëm, Revizioni.

Meqenëse, vlera e paraqitur e kësaj lende si me larte (589,800.65), do te definohet ne te ardhmen, pasi që është ushtruar mjeti i jashtëzakonshëm nga e paditura (ASHNA), pas shterjes se te gjitha mjeteve juridike te ankimimit nga ASHNA, nëse paditësit eventualisht fitojnë lenden, caktohet ekspertiza e ekspertit financiar te kërkuar nga përmbartuesi me qe rast definohet shuma e sakt e borxhit.

- Lënda e paditëses Arjeta Berisha me C.nr 1018/2020. Vlera e kontestit është 9,249.40 euro me procedurë gjyqësore-përmbartimore.
- Lënda e paditëses Vlorë Ferizi ne Cp nr. 330/22. Aktvendim përmbartimore. Vlera e kontestit është 3,957.13 euro.
- Lënda e paditësit Afrim Aziri me PPP nr. 2970/20. Aktvendimi përmbartimorë. Vlera te kontestit është 47,525.30 euro.

2. **Kërkesat dhe padite per toka ne perimetrin e rrethojës se Aeroportit (Kërkesat nga ish pronarët e pronave te ekspropoluara brenda rrethojës se ANP-së - Aeroporti Ndërkombëtarë i Prishtinës te cilat janë ne procedure gjyqësore).**

- Nga viti 2005 personat si me poshtë kane paraqitur kërkesa për lirim te pronave dhe kompensimin te cilat janë ende ne procedure gjyqësore. Ende nuk kemi pranuar padi por vetëm kërkesat tyre jane paraqitur ne gjykatë. Vlera përcaktohet në gjykatë: Paditësit janë: Sava Miqunovic ne sipërfaqe prej 0.33.00 Ha, Qamil Pajziti ne sipërfaqe prej 0.9.Ha, Milorad Stevanovic 0.14.00 Ha, Slavisha Mihajovic 0.51.50 Ha, Zoran Mihalovic 0.47.50 Ha, Dragan Sloguba 0.50.00 Ha, Latif Shala 1.11.20 Ha qe nga viti 2005 - 0.17.00 Ha. Gjithësej në sipërfaqe, 3,33.20 Ha. Deri ne kohen e raportimit, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ka pranuar kërkesa për lirimin e patundshmërisë se pretenduar si te uzurpuar dhe deri me tani, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në afat ligjor ju ka përgjigjur me shkrim palëve.

Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2022	2022-1	2022-2
Ndërtesat	239,992.70	246,354.48	52,499.69
Toka	-	-	-
Paji, te teknologjis informa	16,908.74	-	-
Pajisje(harduer)të IT-ve	3,431.84	8,354.08	10,621.31
Pajisje tjera	445,001.74	212,600.87	136,189.06
Mobile	18,793.75	25,006.09	7,300.81
Makineria	843,590.48	1,518,564.87	2,872,311.92
Automjetet	46,994.67	61,062.65	89,198.61
Tjera	2,877,595.05	4,061,205.40	2,317,500.00
Gjithsej	4,492,308.97	6,133,148.44	5,485,621.40

Auditet nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Gjatë vitit 2022 është realizuar auditimi nga Zyra Komëtare e e Auditimit sipas mandatit dhe normave të aplikueshme. Puna e auditimit e kryer deri më tani është realizuar në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga ONISA.

“Raporti i auditimit për ASHNA për vitin 2022”, përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i ASHNA për vitin 2022. Ky raport pritet të jetë publik deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023.

Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Nr.	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1	Çështja A1 - Keq klasifikim i shpenzimeve Sipas nenit 18 pika 3 te Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike -shpenzimet duhet te jene ne kode adekuate, te përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël.	Gjatë procesimit të transaksioneve nuk janë janë aprovuar shpenzimet që nuk i takojnë kategorisë përkatëse të natyrës së shpenzimit.	Dhjetor 2022	I përmbushur	Prioritet i lartë
2	Çështja A2 Mos prezantimi i detyrimeve ne PFV. Sipas Rregullores se MF. Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, nenit 17, pika 3 kërkon qe organizatat buxhetore duhet te raportojnë te gjitha detyrimet (faturat) te krijuara deri me 31 dhjetor te vitit raportues.	Kontrolli i librit të faturave është raportuar me të gjitha detyrimet (faturat) e krijuara deri me 31 dhjetor te viti raportues	Janar 2023	I përmbushur	Prioritet i lartë
3	Çështja B1. Vonesë në pagesën e obligimeve. Rregulla financiare 01/2013 MF për shpenzimin e parasë publike neni 37, pika , përcakton se te gjitha faturat qe i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se është paraparë ndryshe në kontratë	Është dërguar rregullorja tek personeli i ASHNA-së me vërejtjen për rëndësinë , rekomandimin dhe ndikimet që mund të ketë vonesa e pagesave. Pagesat janë bërë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj	Korrik 2022	I përmbushur	Prioritet i lartë
4	Çështja A3 Mos zhvlerësimi i pasurisë nen 1000€ Rregulla MF- 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare ne organizata buxhetore, neni 22, pika 1, specifikon se, te gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.	Është krijuar baza paralele e të dhënave jashtë E-pasurisë dhe kalkulimi manual i amortizimit në listat e krijuara (Excel).	Korrik Dhjetor 222	I përmbushur	Prioritet i lartë

Menaxhimi i Rreziqeve të Organizatës

Për menaxhimin e rreziqeve të organizatës, ASHNA ka miratuar dokumentin Menaxhimi i Rrezikut, përmes të cilit identifikon rreziqet të cilat mund të kenë ndikim në arritjen e objektivave të saj.

Ky dokument është krijuar bazuar në kornizën ligjore në fuqi dhe azhurnohet në baza vjetore apo më shpesh nëse ka nevojë.

Në vijim do paraqesim disa nga rreziqet kryesore të identifikuara përmes këtij procesi, për vitin 2023.

- Anëtarësimi në institucionet relavante të aviacionit civil;
- Menaxhimi i kodit "Indikator i lokacionit BKPR" që varet nga ICAO dhe partneri komercial Islandez;
- Konkurrenca në tregun rajonal;
- Forcat madhore;
- Pandemitë;
- Mungesa e FIR/e kodit të FIR;
- Largimi i numrit të madh te stafit kyç me aftësi, njohuri dhe eksperiencë relevante;
- Ligji i Pagave;
- Mangësitë e Ligjit (04/ L-250) të ASHNA-së.

Shërbime tjera

Shërbimet e informative Aeronautike (AIS)

ASHNA ofron të dhëna/informacione aeronautike të domosdoshme për sigurinë, rrjedhën e rregullt dhe efikase të trafikut në hapësirën ajrore të Kosovës dhe aeroportet përkatëse.

AIS përbëhet nga njësitë në vijim dhe operon 24/ 7.

- ARO (Aerodrome Reporting Office)
- NOF (International NOTAM Office)
- AIP (Aeronautical Information Publication)

AIS është duke kaluar në një koncept të ri të menaxhimit të dhënave aeronautike të quajtur AIM (Aeronautical Information Management). Ky koncept është mbështetur me instalimin e sistemit të ri, i cili ka treguar përmirësime madhore për përdoruesit, përfshirë edhe përgatitjen e personelit. AIM është implementuar gjatë vitit 2022.

Meteorologjia e Aviacionit (MET)

Shërbimet meteorologjike ASHNA i ka të strukturuar në kuadër të Departamentit Meteorologjik, i cili kryen aktivitetet në vijim:

- Parashikim
- Vrojtim
- Klimatologji

Produktet kryesore të këtij shërbimi janë TAF, LAF AM/PM, Cross Section, 7 Day Forecast, Aerodrome Warnings, Weather Warnings, TAF AMD/COR, LAF AMD/COR, MOR.

Me projektin e zgjatjes së pistës, janë përfunduar edhe një numër nën-projektesh të rëndësishme, të cilat kanë përmirësuar dukshëm performancën dhe cilësinë e shërbimeve meteorologjike.

Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore janë vlera dhe pasuria kryesore e ASHNA-së, të cilëve i'u kushtohet vëmendje e veçantë në të gjitha nivelet dhe proceset.

Duke pasur parasysh specifikat e profileve të funksioneve në ASHNA, vëmendje e theksuar i kushtohet rekrutimit, zhvillimit, trajnimit dhe mirëqenies së personelit të saj, në mënyrë që të sigurohet performancë maksimale në përmbushjen e detyrave të tyre.

ASHNA ka gjithsej 164 të punësuar, të specializuar në fusha të ndryshme, të cilët janë të ndarë në personelin operativ dhe personelin administrativ.

Sigurimi Shëndetësor



Në korrik të vitit 2022, përmes procedurave të prokurimit është nënshkruar Kontrata për Sigurimin Shëndetësor për personelin e ASHNA-së.

Kontrata aktuale është e vlefshme deri me datë 14.07.2023.

Personeli sipas gjinisë



Profili i moshës së nëpunësit




Etniciteti i nëpunësve

Shqiptarë 161

Turk 2

Boshnjak 1



Trajnimet

Bazuar në objektivin e ofrimit të shërbimeve të sigurta dhe cilësore për navigim ajror, kriteret për përgatitje profesionale dhe mbajtje të nivelit të kompetencës së personelit janë relativisht të larta dhe të ndryshueshme, prandaj edukimi dhe ngritja profesionale e zyrtarëve është prioritetet kryesor dhe shumë i rëndësishëm në përmbushjen e këtyre shërbimeve.


Trajnimet e realizuara në vitin 2022, kanë qenë në pajtim me planin e trajnimeve dhe me kërkesat e domosdoshme që kanë ardhur si rezultat i procesit të zhvillimit të institucionit dhe të avancimit të stafit. Pjesa më e madhe e trajnimeve kanë qenë ndërkombëtare, të cilat edhe kanë pasur një kosto më të lartë financiare, por kemi realizuar edhe trajnime në rajon, trajnime vendore si dhe trajnime induktive. Po ashtu, në këtë vit kemi pasur bashkëpunim të mirë me institucionet vendore dhe publike për trajnime, ku një numër i madh i trajnimeve janë realizuar në IKAP. Trajnimet e kryera i klasifikojmë si :

- ndërkombëtare;
- regjionale;
- vendore.

Trajnimet kryesore të zhvilluara gjatë këtij viti janë:

- Trajnimi “PBN IFP Conversion Training”
- Trajnimi për ATSEP- Basic
- Trajnimi Rifreskues për KTA
- Trajnimet me IATA
- Trajnimi: ELPAC per ATSEP

Trajnimet në regjion janë mbajtur nga kompani vendore për zyrtarët e shërbimeve administrative, përkatësisht departmenteve të Financave, Administratës, Prokurimit, zyrtarëve të Kabinetit dhe të Auditimit. Në regjion janë mbajtur trajnime edhe për zyrtarët e komisioneve Disiplinore dhe të Ankesave. Trajnimet vendore kryesisht janë mbajtur në IKAP dhe Ministri të Financave, që kanë qenë trajnime rifreskuese dhe që kanë qenë të nevojshme për mbajtje të kompetencës së zyrtarëve administrativ.



Plani i Trajnimeve për vitin 2023

Përgjatë përgatitjes së këtij plani, përveç synimit për përmbushjen e obligimeve ligjore/rregullative për trajnime në fusha të caktuara, rëndësi e veçantë i është dhënë edhe zhvillimit profesional të zyrtarëve si dhe vetëdijësitimit për funksionet dhe rëndësinë e shërbimeve që ofron ASHNA.

Plani synon gjithashtu përgaditjen e personelit për ndryshimet në strukturën e hapësirës ajrore, zgjerimin e fushëveprimit, me theks të veçantë përgaditjen për menaxhim të plotë të hapësirës ajrore të Kosovës.



Priroritetet për 2023

Prioritet e ASHNA-së për vitin 2023 janë si në vijim:

- Prokurimi i sistemit “ATM- Air Traffic Management”
- Ndryshimi/ plotësimi i Ligjit të ASHNA-së
- Normalizimi i hapësirës ajrore
 - ✓ Hapësira e ulët - hapja e pikave dhe rrugëve ajrore me Malin e Zi
 - ✓ Hapësira e lartë – përgaditja e personelit
- Rekrutimi dhe trajnimi i Kontrollorëve të Trafikut Ajror
- Transformimi nga sistemi konvencional radarik në MLAT
- Kalimi në energji të ripërtëritshme “Green”
- Anëtarësimi në CANSO Europe
- Integrimi në Eurocontrol
- Funksionalizimi i plotë i MSSR –it të Goleshit



10 A

101

101B